



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1228/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Ragip Mehmeti kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Lipjan nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit për shkak të manipulimit dhe të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Ragip Mehmeti kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

### Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Ragip Mehmeti kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Lipjan nga radhët e subjektit politik LDK, me të cilën pretendon se me datë 3 nëntor gjatë numërimit të votave i janë vjedhur votat nga komisionarët dhe kundër kandidatët e LDK-së në këto qendra të votimit: QV Magure 1302e VV 01.02.03.04.05.06 : QV Rufc i Ri 1323e VV 01.02.03 dhe QV Resinovc 1324e. Parashtruesi i ankesës thekson se nuk përputhen rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ-ja me datën 02.11.2013 dhe se me këtë rast kërkon rinumërim të votave në QV e lartcekura.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Ragip Mehmeti se i mungojnë votat dhe se ka mospërputhje të rezultateve, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk

ka bashkangjitur asnjë provë që do ti vërtetonte ato për të cilat pretendon, pasi që në asnjë moment nuk ka arritur që të vërtetoj me ndonjë provë zyrtare numrin e votave të publikuar nga rezultatet preliminare dhe ato përfundimtare, por pretendimet e tija i mbështet në supozime dhe jo në fakte konkrete. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Anr. 1228/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.